



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



## **NDYSHIMI DHE PLOTËSIMI I METODOLOGJISË SË TAKSAVE TË KYÇJES NË RRJETIN E TRANSMETIMIT**

**Shtator 2020**

**Prishtinë**

---

Adresa: Rr. Dervish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: [info@ero-ks.org](mailto:info@ero-ks.org), web: [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org)

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë me Nenin 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 dhe Nenin 26 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit për Rregullatorin për Energji Nr. 05/L-084, Nenin 16 par.1 nënpar. 1.16 të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085 dhe Nenin 11 të Licencës për Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, në seancën e mbajtur me datë 30.09.2020 miratoi:

## **NDYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E METODOLOGJISË SË TAKSAVE TË KYÇJES NË RRJETIN E TRANSMETIMIT**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Qëllimi i këtij amendamenti është ndryshimi dhe plotësimi i Metodologjisë së Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit të aprovuar nga Bordi i ZRRE-së, me Vendimin V\_1015\_2018 të datës 12.07.2018.

### **Neni 2**

Neni 6.6 teksti "*grupe matëse*" ndryshohet me tekstin si në vijim "*sistem matës*".

### **Neni 3**

Neni 6.7 plotësohet dhe ndryshohet paragrafi i fundit me tekstin si në vijim:

*Draft Marrëveshja për Kyçje (në formë elektronike) do t'i bashkëngjitet Ofertës për Kyçje. Marrëveshja për Kyçje nënshkruhet brenda 30 ditëve pas përgjigjes me shkrim për pranim të Ofertës për Kyçje nga Aplikuesi.*

### **Neni 4**

Shtohet Nenin 6.7.1 me tekstin si në vijim: **Kohëzgjatja e vlefshmërisë së Marrëveshjes për Kyçje**

*Marrëveshja e Kyçjes do të lëshohet për dy (2) vite apo deri në kohëzgjatjen e Autorizimit për ndërtim nga ZRRE. Nëse brenda kësaj periudhe, Aplikuesi nuk fillon procesin e implementimit (ndërtimit) të projektit, atëherë Marrëveshja e Kyçjes e nënshkruar nga KOSTT dhe Aplikuesi do të konsiderohet jo valide dhe procesi do të kthehet në fazën fillestare që nënkupton se Aplikuesi duhet të ri-aplikoj për kyçje. Aplikuesi brenda periudhës së vlefshmërisë së MK-së ka të drejtë të kërkoj para skadimit të afatit një shtyrje prej gjashtë (6) muaj për zgjatjen e validitetit të Marrëveshjes së Kyçjes duke sqaruar me shkrim arsyen e kërkesës për zgjatje të MK-së. Nëse Aplikuesi brenda kohës shtesë nuk arrin të filloj projektin, apo nuk ka Autorizim për ndërtim të lëshuar nga ZRRE procesi kthehet në fazën fillestare dhe Aplikuesi duhet të ri-aplikoj për kyçje.*

#### Neni 5

Shtohet Nenin 6.7.2 me tekstin si në vijim:

*“Aplikuesit të cilët posedojnë Marrëveshje për Kyçje në Rrjet të lëshuar para hyrjes në fuqi të amendamentimit të kësaj Metodologjie, do të trajtohen sipas Metodologjisë së Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit të aprovuar nga Bordi i ZRRE-së, me Vendimin V\_1015\_2018 të datës 12.07.2018, dhe do të mbesin në fuqi të pandryshuara”.*

#### Neni 6

Dispozitat tjera të Metodologjisë së Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit të aprovuar nga Bordi i ZRRE-së, me Vendimin V\_1015\_2018 të datës 12.07.2018, do të mbeten të pandryshuara dhe do të zbatohen në tërësi.

#### Neni 7

Ndryshimi dhe plotësimi i Metodologjisë së Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit i aprovuar nga Bordi i ZRRE-së me Vendimin V\_1015\_2018 të datës 12.07.2018, hyn në fuqi pas datës së aprovimit nga Bordi i ZRRE-së.


#### Neni 8

KOSTT obligohet që amendamentimin e Metodologjisë së Taksave të Kyçjes në Rrjetin e Transmetimit ta publikoj në faqen elektronike të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, pesëmbëdhjetë (15) ditë përpara datës së fillimit të aplikimit.

**Bordi i Rregullatorit:**

  
Arsim Janova, u.d. kryesues

  
Besim Sejfi, anëtar

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar